



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 07 maj 2019, në mbledhjen e XII-të (dymbëdhjetë), mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.25’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Fatlume Jaha, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fitim Haziri, Adelinë Stublla, Rafet Llapashtica dhe Floretë Zejnullahu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë – DPKGJ, Agim Blakçori, drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Mirsad Kamerolli, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE.

Të pranishëm ishte edhe përfaqësuesi nga Rrjeti i OJQ-ve, Rexhep Zeka.

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit dhe njoftuar rreth pikave të paraqitura në këtë rend të ditës, dhe shtoi, nëse ndokush ka diçka rreth rendit të propozuar të ditës mund ta merr fjalën, nëse jo vazhdojmë me punë.

z.Fitim Haziri, theksoi, dëshiroj të ndërlidhem rreth Planit të Punës dhe marrëveshjes që kemi pasë bashkërisht si Grupe të këshilltarëve, plan i cili nuk është duke u përfillur, andaj dëshiroj të dim arsyet përse nuk sjellën pikat e rendit të ditës të parapara me plan dhe që bashkërisht i kemi votuar në këtë Kuvend. Pra për këtë muaj-mbledhje është paraparë raport i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, raporti i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, por që nuk janë sjellë, andaj a ka ndonjë arsye. Gjithashtu ne bashkërisht jemi dakorduar që mbledhjet e KPF-së të mbahen 2-3 ditë para mbledhjeve të Kuvendit.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, vërtetë që jemi dakorduar që mbledhjet e KPF-së të mbahen të paktën një ditë para mbledhjeve të Kuvendit në mënyrë që të shpërndahen materialet, mirëpo kësaj radhe për shkak të disa festave zyrtare që kanë qenë dhe që është dhe më 09.05.2019 kemi caktuar kështu mbledhjen e Kuvendit, si dhe me qëllim të procedimit të kompensimit të këshilltarëve.

Sa i përket çështjes tjetër për pikat e parapara në Plan të punës, unë mund të them se të gjithë janë të informuar me Planin e miratuar të punës, dhe çfarëdo që sjellët nga ana e Ekzekutivit të Komunës unë i procedoj për seancë, mirëpo pa pasur material unë nuk mund të vë rendit të ditës.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, ju këshilltarët e Kuvendit keni hartuar planin e punës, por pa pjesëmarrjen e Ekzekutivit, në emër të të cilit po foli tani. Ne Drejtorët, sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, jemi të obliguar t'i raportojmë Kryetarit të Komunës, çka edhe e bëjmë, por jo edhe Kuvendit të Komunës. Ne mund të japim informata, por jo edhe raport, kështu e parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale.

z.Fitim Haziri, theksoi, Ligji për vetëqeverisje lokale e parasheh edhe atë që ne këshilltarët e Kuvendit, apo si Kuvend në tërësi, mund të kërkojmë raport nga ju drejtorët dhe ju jeni të obliguar të sjellni.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, raport jo, informatë po mund të sjellim ashtu sikurse që kemi vepruar edhe në të kaluarën. Raport i japim vetëm Kryetarit të Komunës. Kështu që ju keni hartuar një planifikim pa përfaqësuesin e Ekzekutivit, andaj kjo ka qenë arsyeje pse ne nuk kemi sjellë në Kuvend raportet e parapara, jo pse nuk i kemi.

z.Fitim Haziri, theksoi, ajo që u tha nga Drejtori, nuk është arsye e besueshme asnjëherë. Kryesuesi i Kuvendit ende pa filluar ta hartojmë planin, ka kërkuar nga ju drejtorët t'i paraqitni pikat e juaja të parapara për t'i futur në rend të ditës, dhe ju nuk ju keni përgjigje ftesës së Kryesuesit, andaj ne bashkërisht i kemi përfshirë disa pika në rend të ditës, dhe në këtë aspekt ne do të insistojmë të sjellni raporte dhe informata të tilla.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, informata do t'ju sjellim, kurse raport jo sepse nuk e parasheh ligji.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, besoj se u sqaruar mes vete, andaj e hedh në votim rendin e propozuar të ditës,

Pas votimi u konstatua se me 7 vota për, 2 vota kundër, u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe pikave të parapara së bashku me materialin përkatës.

1. Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më: 28 shkurt 2019; dhe 28 mars 2019

Me 7 vota për, 2 vota të përmbajtura dhe asnjë votë kundër, pa vërejtje, u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më: 28 shkurt 2019 dhe 28 mars 2019.

2. Propozim Vendimet për miratim paraprak / dhënien në shfrytëzim:

- **Prona e paluajtshme e Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm**
- **Prona e paluajtshme e Komunës në fshatin Dumnicë e Poshtme,**
- **Lokalet në Tregun e Qytetit, dhe**
- **Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim KEDS-it**

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, rreth kësaj pike, kemi 4 propozim vendime për dhënie të pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, andaj fjala është për drejtorin e Drejtorisë përkatëse që të jep sqarimet dhe arsyetimet e nevojshme.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, kemi 4 propozim vendime për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, fjala është për një pronë në Lupç të Poshtëm vendi i quajtur Bugurdoll, parcela 495/1, parcelë e cila në të kaluarën e kemi dhënë në shfrytëzim për ndërtimin e një fabrike të peletit, tani kemi një kërkesë prej një qytetari tonë i cili merret me përpunimin e drurit, dhe sipas fjalëve të tij është një ofertë nga një investitor amerikan për punësim të 20 punëtorëve dhe ka kërkuar 20 ari apo 2000 m². Procedura rreth kësaj do t'i përfillet Ligjit të ri nr.06/L-092 i cili ka hyrë në fuqi, dhe do t'i preferohet Komisionit përkatës të vazhdoj me procedurat përkatëse, mirëpo paraprakisht duhet miratim nga ana e Kuvendit për dhënien e pronës së cekur në shfrytëzim, e cila do të jepet në afatshkurtër, 15 vite.

Propozimi tjetër është në fshatin Dumnicë e Epërme ku nga viti 2002 kemi një familje të cilës nga Komiteti Komunal për Strehim, Kryetar i të cilit ka qenë i ndjeri Agim Kikaj, asaj familje ju janë dhënë 5 ari truall, dhe ka pasë shtëpinë 50m afër kufirit me Serbinë, andaj si Komitet ia kanë lejuar t'i jepet prona komunale, fjala është për parcelën 74/1 e cila është 2 hektar e 10 ari, dhe ajo familje është zgjeruar paksa dhe ka bërë një kopsht. Në të kaluarën qytetarët kanë bërë një kërkesë për uzurpim, ne kemi dal në terren dhe kemi konstatuar se është bërë uzurpim dhe në ndër kohë ka disa vite që ai pronar kërkon nga Komuna t'i jepet në shfrytëzim me qira ajo pjesë, dhe duke pasë parasysh si familje sociale, kemi propozuar që t'i jepet në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, rreth 5 ari, rrethit të asaj parcele prej 20 ari, por me qira, që do të thotë se kemi të bëjmë për herë të parë që një pronë jepet afatgjatë, mirëpo me Ligjin e ri që ka hyrë në fuqi, nuk ka shumë ndryshime nga ai i kaluari, do të thotë Komisioni përkatës e jep atë pronë në shfrytëzim, i njëjti shpallë ofertën publike, do të thotë nuk është sikur më parë që ka qenë me konkurs, por bëhet me një ofertë të njëjtë, përjashtimisht që pas vendosjes së ofertave nga Komisioni përkatës, vendimi i atij Komisioni kthehet sërish në Kuvend për miratim. Do të thotë nëse janë 2-3 apo më shumë ofertues, caktohet ai që ka çmimin më të volitshëm, dhe sjellët në Kuvend për miratim, dhe tek atëherë, nëse miratohet, kalon tek Kryetari i Komunës për nënshkrimin e kontratës, pra nuk është sikurse për afatshkurtër që nuk sjellët më në Kuvend.

Pastaj kemi propozimin për dhënie në shfrytëzim lokalet që gjenden në Tregun e Qytetit, çështje për të cilën sigurisht jeni në dijeni se në vitin 2010-2011 është zhvendosur ai treg në atë pjesë të qytetit për shkak se Komisioni Evropian ka pas projektin për ndërtimin e objektit të ri të Komunës. Pra ato lokale i janë dhënë ish tregtarëve që kanë qenë në ish tregun. Pra kemi të bëjmë me 35 lokale të ndërtuara dhe të shpërndara në vitin 2012, si dhe 20 lokale më vonë në vitin 2013, dhe të gjitha këto lokale janë shpërndarë nga një Komision i Komunës. Nuk e di arsyen e mos funksionalizimit të një numri të atyre lokaleve, për arsye ekonomike apo mos leverdisë eventuale, prej tyre 7 kontrata nuk janë nënshkruar fare, pastaj kemi 6 kërkesa për shkëputje të kontratave me qëllim të mos krijimit të borxheve, si dhe ka edhe mjaft lokale tjera që në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit kemi pas një takim me disa prej atyre personave dhe atyre që punojnë dhe i mbajnë ato lokale që të gjejmë zgjidhje për të funksionalizuar lokalet në Tregun e Qytetit, përndryshe ne do t'i shkëpusim kontratat, mirëpo më nuk mund t'i japim në shfrytëzim me atë Komision por duhet të veprojmë me njoftime - ankand publik për ata persona që janë të interesuar të punojnë në mënyrë që qytetarët të krijojnë të ardhura dhe njëkohësisht edhe Komuna të përfitoj nga qiraja e që është edhe qëllim i Komunës.

Sa i përket propozimit për dhënie të pronave të paluajtshme KEDS-it, kemi një situatë të cilën e kam paraqitur edhe në Zyrën ligjore por po e paraqesë edhe në këtë Komitet, fjala është se kemi pasë kërkesën e KEDS për dhënie në shfrytëzim disa pjesë të rrugëve publike, kërkesë e cila është sjellë më 01.03.2019 dhe tjetra 12.03.2019, do të thotë janë sjellë në kohën kur ka qenë në fuqi ligji i vjetër, sepse në ligjin e ri për dhënien e pronave të paluajtshme në shfrytëzim, parashihet që prona komunale të jepet në shfrytëzim për qëllime të energjisë së ripërtëritshme, çka që me këtë ligjin e ri kjo nuk mund të kaloj

por meqë kërkesat janë sjellë paraprakisht në fillim të muajit mars, KEDS nuk është fajtor pse ne, për shkak të ngarkesave të seancës së muajit mars nuk e kemi poseduar këtë pikë. Dua të them që kjo pikë do të kalojë me ligjin e vjetër dhe si e tillë kemi propozuar që të jepen përfundimisht edhe këto pjesë të pronave, gjë që ju kemi treguar edhe zyrtarëve të KEDS që ne më nuk do të procedojmë kërkesat e juaja, për shkak se ligji i ri që ka hyrë në fuqi nuk e lejon një gjë të tillë. Mirëpo meqë kërkesat që janë propozuar tani janë të muajit mars dhe si të tilla, t'ju refuzohen pa të drejtë nuk është e arsyeshme, kështu që edhe pse është propozuar dhe do të vendoset me vonesë, ka të bëjë me ligjin e vjetër.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, e rëndësishme është që të jenë në kuadër të ligjeve dhe akteve tjera normative.

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të LDK-së përkrah propozim vendimet sipas kësaj pike të rendit të ditës. Natyrisht që me ligjin e ri është specifikuar edhe më qartë fushveprimtria dhe obligimet e Komisionit përkatës. Uroj që në këtë vit ashtu siç ka filluar më mbarë të punoj Komisioni për dallim nga viti i kaluar që nuk është vërejtur ndonjë punë e madhe e komisionit, të cilit i rikujtojmë që nuk e ka për obligim vetëm të presin kërkesa që vijnë prej qytetarëve, por ka për obligim që edhe t'i identifikojnë ato prona dhe të rishikojnë mundësinë e krijimit të të hyrave edhe për Komunën për arsye se ka shumë prona të rëndësishme që janë në Komunën tonë që ndoshta njerëzit nuk i dinë duke përfshirë edhe biznesmenët tanë, që do të mund t'i shfrytëzonin ato, kështu që inkurajoj që Komisioni të punoj edhe më shumë në identifikimin e dhënies së pronave komunale në shfrytëzim, konform ligjit dhe Rregullores që është në fuqi.

z.Fitim Haziri, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, përkatësisht propozim vendimeve përkatëse sipas materialit përkatës, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe diskutim. Vlen të theksohet se jemi për, sa i përket 3 propozim vendimeve të para, ndërsa sa i përket propozimit për dhënien e pronave KEDS-it, jemi kundër.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, dua të ndalem paksa rreth propozim vendimit të dytë, në bazë të asaj që drejtori paraqitës e tha në fjalën hyrëse. Në parim jam që të mbështetet ai personi i fshatit Dumnice e Poshtme të cilin nuk e njoh dhe as nuk po e di kush është, por që të njëjtë ju paskan dhënë rreth 5 ari me vendim të Komunës para rreth dy legjislaturave, për ndërtimin e shtëpisë dhe qenka në brez kufitar, është shumë në rregull, por sa kuptova i njëjti paska paraqitë kërkesë edhe për 20 ari tjerë e që edhe kjo është në rregull e që ndoshta po ta shikojmë në aspektin e përgjithshëm por edhe kombëtar dhe komunal do të ishte mirë t'i jepej ajo pronë ati personi me qëllim të qëndrimit të asaj familje në vend të vetin, mirëpo ajo që deshta të ngrisë rreth dhënies së asaj prone në shfrytëzim atij personi sipas kërkesës, në bazë të Ligjit është paksa e koklavitur sepse ajo pronë del në ankand për dhënie në shfrytëzim dhe si rrjedhojë mund të oferton ndokush me 0.50 € më shtrenjtë dhe ta merr të njëjtën, do të thotë që duhet të ketë kujdes në këtë aspekt rreth procedurave sepse bëhet fjalë për një person i cili ka bërë kërkesë.

Sa i përket propozimit për dhënie në shfrytëzim me qira, lokalet në Tregun e Qytetit, gjithsesi mendoj se tregu duhet të funksionalizohet dhe ato lokale duhet të jepen në shfrytëzim, edhe pse është shumë e vërtetë që ndarja që është bërë më parë e atyre lokaleve ka qenë ndarja më e keqe e mundshme për arsye se ato lokale kanë qenë defunksionale dhe është e vërtetë se janë ndarë edhe në aspektin politik, andaj në këtë kuptim pyes Drejtorin se a janë bërë barazimet e qirasë dhe borxheve që kanë pasë shfrytëzuesit e mëparshëm, përndryshe ata që nuk kanë shlyer obligimet duhet t'iu shkëputen kontratat dhe të bëhen barazimet apo të shkohet me procese gjyqësore, kurse dhënie në shfrytëzim e mbështes.

Sa i përket propozimit për dhënie të pronave KEDS-it për energji të ripërtëritshme sipas kërkesave që ka bërë, Drejtori në fjalën hyrëse e tha që na duhet të marrim vendim në bazë të ligjit të vjetër, mirëpo unë e them se Kuvendi i Komunës, Institucionet por edhe ne fizikisht, vendime mund të marrim vetëm në bazë të ligjeve në fuqi, vendimet merren me ligjet në fuqi, por jo me ligje që kanë qenë dhe që nuk janë në fuqi. Vonesa e sjelljes në Kuvend të atyre kërkesave janë defekt personal i juaj Drejtor, andaj, edhe

pse në të kaluarën i kam mbështetur kërkesat e tilla të KEDS-it dhe atë për hir të qytetarëve, tani mendoj se nuk mund të marrim vendim jashtëligjor për dhënie në shfrytëzim sepse e përsëris që vendimet merren me ligje në fuqi, kështu që rreth kësaj pike mendoj se me çdo interpretim ligjor edhe të MAPL, një vendim i tillë do të hudhej si i jashtëligjshëm. Mendoj se aty për aty është dashtë t'ju kthehej përgjigja KEDS-it, për arsye se në Kuvend nuk mund të marrim vendim në bazë të një ligji që ka qenë dhe që nuk është më në funksion, por që kemi ligjin e ri tani që ka hyrë në fuqi, dhe juridikisht çdo ligj, plotësim ndryshim apo amandamentimi i ndonjë ligji e hedh prej funksioni ligjin e vjetër, duke përjashtuar veprat penale në raste të ngjashme ku nëse është ngritë aktakuzë, dënimi merret në bazë të ligjit që ka qenë në fuqi, përndryshe në proceset administrative vendimet merren me ligje në fuqi.

Unë individualisht nuk jam që të pengohet kjo çështje, mirëpo kërkoj edhe nga Kryesuesi i Kuvendit ta analizoj edhe vetë këtë çështje. Drejtori e ceku këtë çështje sot këtu në KPF, mirëpo është shumë e panatyrshme që në Kuvend të thuhet e njëjta gjë nga ana e Drejtorit të DPKGJ, sepse ai vetë bie keq, konkretisht të thuhet që ai ligj nuk është në fuqi por ne po marrim vendim duke u bazuar në atë sepse kërkesat kanë ardh sa ai ka qenë në fuqi, mirëpo si të dëshironi ju. Ne mund ta shqyrtojmë dhe analizojmë më në detaje në këtë mbledhje, por nëse dëshironi edhe e rekomandojmë në Kuvend, pse jo, por në Kuvend po marrin pjesë edhe media dhe po përcillen mbledhjet, dhe si rrjedhojë nuk po mund të rri dhe të dëgjoj dhe mos të reagoj për gjëra të tilla, kështu që këtë propozim vendim do t'ju sugjeroja ta rishqyrtoni deri nesër.

Sa i përket Komisioni për dhënien e pronave në shfrytëzim, është fakt që platformat rreth pronave përfshirë projektet etj etj, i bëjnë drejtorët dhe ia paraqesin Kryetarit, por është obligim ligjor dhe moral i drejtorëve që t'jua sjellin komisionit, kushtet, kriteret dhe çështje tjera me rëndësi rreth pronave përkatëse në mënyrë që Komisionit të mund të zhvillojnë procedura dhe të marrin vendime më lehtë.

Pra të dërgohen kushtet e vëna nga Ekzekutivi i Komunës për atë pronë që parashihet të jepet në shfrytëzim, përndryshe Komisioni nuk mund të kryej punën e vet. Këtë që e ceka jam i njoftuar nga anëtarë jonë i PDK-së që është në atë Komision.

Ne tani nuk mund të kërkojmë llogari as nga ata që kanë dhënë në shfrytëzim lokalet në Tregun e Qytetit dhe nuk është kryer asnjë obligim, e që nuk po funksionon shteti dhe ligji sepse për këtë dikush do të duhej të jepte llogari pse i është dhënë një personi me tre emra të ndryshëm lokale në atë treg, dhe që të tri ato lokale kanë qenë mbyllur deri tani.

Pra për fund, propozimi për dhënie të pronës KEDS-ti është jashtë normave dhe këtu e them se nuk mund ta mbështes nesër në Kuvend sepse është në kundërshtim me ligjin, dhe për këtë po foli jo politikisht por në bazë të dokumentacionit dhe asaj që Drejtori e tha. Kurse për pikën e dytë që ka të bëjë me një person në fshatin Dumnicë, që t'i jepet pronë në shfrytëzim, nuk e di se si do ta rregulloni me metodat me juaja që ai person të jetë përfitues, pra kemi të bëjmë për një periudhë 99 vite, që në një mënyrë ne duhet ta legjitimojmë atë pronë, mirëpo unë mendoj që nëse nuk kemi mundur të kemi nën kontroll lokalet në mes të qytetit, në atë fshat nuk mendoj fare se mund të kemi kontroll. Pra si pika i mbështesim që të rekomandohen për Kuvend por si koncentrim kisha këto dy nënpika (çështja e pronës në Dumnicë të Poshtme si dhe çështjen e konfliktit ligjor për dhënien e pronave KEDS-it).

Drejtori e tha se kërkesat janë sjellë me 1 dhe 13 mars, juridikisht nuk keni aspak të drejtë sepse e përsërisë për të satën herë që nuk kemi të drejtë të marrim vendime me ligje të kaluara. Ne kemi interes prej energjisë së ripërtëritshme dhe jam për investime të tilla, mirëpo si do që të jetë si propozim ju dërgojeni në Kuvend, merrni vendim dhe të shohim si po kthehet vlerësimi nga MAPL.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, sa e kuptova drejtorin e DPKGJ, kërkesat janë bërë sa ka qenë në fuqi ligji i vjetër, në ndërkohë ka hyrë në fuqi ligji i ri, andaj ju Drejtor e cekët se kërkesat e KEDS-it janë sjellë sa ka qenë në fuqi ligji i vjetër, dhe të njëjtat i keni proceduar tani po me atë ligj. Tani të

flasim të drejtën, ligji i ri paska hy në fuqi afërsish në mes të muajit prill, andaj a mund të japësh edhe disa sqarime i nderuar Drejtor.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve e bënë MAPL, dhe unë jam shumë i bindur se edhe MAPL nuk do ta hudh këtë vendim. Unë deshta të jem shumë i kjoartë dhe i sinqertë para jush sepse fundja do mund të kamufloja dhe ndoshta askujt nuk do ti binte në sy, por deshta të paraqes problemet para juve. Rreth afateve dhe parashkrimi i afateve, ligji bazik i procedurës administrative e thot, nëse pala e dorëzon edhe në adresë të gabuar një kërkesë, nuk parashkruhet afati, do të thot nuk humb afati. Në rastin konkret, KEDS ka paraqit kërkesë në Qendrën e Shërbimit për Qytetarë, ajo afatin e ka, pse ne nuk kemi mund të procedojmë në seancën e muajit mars është për shkak të ngarkesave të rendit të ditës me pika të shumta, por e kemi prolonguar për këtë seancë. Do të thotë se nuk është shkelje ligjore kjo, dhe për këtë jam shumë i bindur duke u bazuar edhe në përvojën time dhe dijen që kam sa i përket juridiksionit dhe këtyre ligjeve pronësore që janë, që ky vendim do të kthehet i ligjshëm prej Ministrisë, do të thot se ne e kemi edhe filtrin e fundit sa i përket shkeljeve apo jo të ligjit. Më 01 mars dhe 12 mars 2019 janë bërë kërkesat nga KEDS-i. Ne edhe më parë kemi diskutuar rreth kësaj çështjeje, dhe prona të tilla kemi dhënë në shfrytëzim për hir të qytetarëve, por jo për hir të KEDS-it, pra ju kemi dhënë prona KEDS-it për t'ju lehtësuar jetën qytetarëve sepse të gjithë jemi në dijeni se çfarë gjendje ka qenë energjia elektrike (me 90W), kurse tani është fat që po investohet në Komunën e Podujevës dhe po rregullohet standardi për qytetarët tanë, madje vetëm në këtë propozim kemi 11 trafo të reja që do të vendosen, dhe atë në fshatrat Gllmanik 3 trafo, në Dumnicë të Poshtme 2 trafo, në Llaushë 1 trafo, në Balloc 1 trafo, në Tërnavë 2 trafo, në Halabak 1 trafo dhe në Metehi 1 trafo, dhe krejt këto varen prej këtij propozimi se a do të kaloj apo jo, ndërsa unë jam i sigurt që do të kaloj.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, nga pozita që jam, në parim e them që është mirë të mos dalim jashtë normave ligjore, gjithherë të përfilllet ligji dhe të mos vëhemi në pozita që të ndërmarrim diçka që nuk kalohet, mirëpo meqë Drejtori i DPKGJ po e arsyeton që kërkesat janë bërë në kohën kur ligji i vjetër ka qenë në fuqi, unë ju sqaroj që seanca e kaluar është mbajtur më 04 mars 2019, kurse kërkesat qenkan bërë më 01 dhe 12 mars 2019, do të thotë që nuk kanë mund të procedohen për shkak se 8-9 ditë përpara shpërndahen materialet dhe pikat e rendit të ditës, dhe si rrjedhojë nuk paska qenë e mundur të procedohen për atë mbledhje këto dy kërkesa, pra të kemi mirëkuptim sa i përket kësaj sepse nuk ka pasur mundësi të jenë pika të rendit të ditës në atë mbledhje për shkak të afateve.

z.Abaz Llugaliu, Drejtor i DPKGJ, theksoi, e di që ka qenë një problem diçka që nuk kanë mund të procedohen ato kërkesa për mbledhjen e muajit mars.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, besoj që u sqaruam rreth kësaj çështjeje, atëherë nëse ndokush ka diçka rreth kësaj pike, përkatësisht rreth këtyre propozim vendimeve, urdhëroni nëse jo e hedh në votim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimeve sipas kësaj pike të rendi të ditës (me përjashtim të nënpikës 4 për të cilën anëtarët e LVV-së Fitim Haziri dhe Adelinë Stublla ishin kundër)

3. Propozim Programi Trevjeçar i Banimit 2019 – 2021 në Komunën e Podujevës

- **Propozim vendimi për vënie në diskutim publik**

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, ju njoftoj që drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS nuk është prezent sot ngase siç më ka njoftuar ka një takim të rëndësishëm në Asociacionin e Drejtorëve të Drejtorive përkatëse, mirëpo materialet i kemi para vetës dhe besoj që mund të vazhdojmë me këtë pikë edhe pa prezencën e Drejtorit.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, kemi të bëjmë një Program i cili është propozuar për vënie në diskutim publik, dhe krejt çka ne mund të bëjmë është si orientim të vendosim për datat e diskutimit publik dhe datën e debatit me qytetarë dhe njëkohësisht t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, rreth vënie në diskutim dhe debat publik me qytetarë, Drejtori i DSHMS më ka dhënë datat kur mund të mbetet një gjë e tillë, dhe atë; është propozuar që nga data 13 maj 2019 deri më 10 qershor 2019 të jetë në diskutim publik ku çdo qytetarë mund të jap sugjerime, propozime apo edhe vërejtje eventuale, të cilat mund të bëhen në adresat e paraqitura në propozim vendim, ndërsa debati publik me qytetarë është propozuar të mbahet më 29 maj 2019, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ora 11:00, në të cilën po ashtu çdo qytetarë mund të paraqesë qoftë në formë të shkruar qoftë verbalisht propozime, vërejtje dhe sugjerime. Detaje tjera janë në propozim vendimin përkatës, andaj nëse ndokush ka diçka rreth kësaj pike urdhëroni, nëse jo e hedhim në votim që t'i rekomandojmë Kuvendit.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të propozim vendimit për vënie në diskutim publik të Programit Trevjeçar të Banimit 2019-2021 me propozim që diskutimi publik të jetë nga 13 maj 2019 deri më 10 qershor 2019 ndërsa debati publik me qytetarë të mbahet më 29 maj 2019 nga ora 11:00

4. Raporti Financiar periudhën janar – mars 2019

z.Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave - DBF, e paraqiti raportin në pika të shkurtra, ndër të tjera theksoi, kemi të bëjmë me raport financiar tre mujor, për dallim nga raportet tjera të viteve të përparshme, karakteristikë e këtij raporti është se dy muajt e parë të vitit 2019 kemi punuar me buxhetin e vitit 2018 për shkak të mos miratimit me kohë të buxhetit për vitin 2019 nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ndërsa muaji mars ka filluar me buxhetin e vitit 2019. Kjo periudhë kohore përfshinë një shpenzim të buxhetit prej 3,541,416.00€, e që nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është një ngritje prej rreth 4%.

Po ashtu si karakteristikë tjetër është se të hyrat vetanake kemi një inkasim prej 337,535.00€ e që nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kemi një rritje prej 25% të inkasimit të të hyrave. Ashtu siç shihet edhe në tabelën e të hyrave, tek të gjitha llojet e të hyrave, përjashtim 1 ose 2 prej tyre, është një ngritje sado që është e lehtë, gëzon fakti që ngritja ekziston, sidomos vërehet rritje tek tatimi në pronë dhe tek të hyrat nga qiraja, pastaj ka një zbritje tek bashkë pagesat në arsim dhe shëndetësi si dhe një rënie e vogël tek certifikatat e gjendjes civile që kërkesat e qytetarëve rezulton të jenë më të vogla. Pra kjo është në pika të shkurtra rreth raportit tremujor financiar, kurse detaje tjera sigurisht që i keni analizuar në materialin përkatës, por gjithashtu për çka do që jeni të interesuar mund të sqarohemi gjatë diskutimeve.

z.Avni Fetahu, në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së u deklarua që e përkrahin dhe i rekomandojnë Kuvendit për diskutim.

z.Fitim Haziri, në emër të Grupit të këshilltarëve të LVV-së po ashtu e përkrahi që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim, dhe potencoj se në mbledhjen e Kuvendit do t'i paraqesim vërejtjet tona që i kemi.

z.Rafet Llapashtica, po ashtu në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e përkrahi që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për diskutim

5. Emërimi i anëtarëve në Komisionet e Aksionarëve në:

- **Ndërmarrjen Publike Stacioni i Autobusëve – Podujevë.....(dy anëtarë/e)**
- **Ndërmarrjen Publike për Banim Sh.A.- Podujevë.....(dy anëtarë/e)**

z.Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSH, e paraqiti fjalën hyrëse ndër të tjera theksoi, sipas ligjit parashihet që në çdo fillim të mandateve të Kuvendeve të Komunave të emërohen anëtarët e Komisioneve të Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale ku dy anëtarë emërohen nga Kuvendi i Komunës dhe nga një anëtar emërohet me vendim nga Kryetari i Komunës. Pse nuk janë ngritë komisionet në fjalë në vitin e kaluar kjo është për faktin që plotësim ndryshimi i ligjit përkatës është në procedurë e sipër sipas të cilit parashihen ndryshime të madha, me theks sa i përket Komisionit të Aksionarëve në Ndërmarrjet Publike Komunale ku nuk do të ketë më Komisione të tilla të Aksionarëve siç parashihet me këtë ligj i cili është në fuqi, por do të jetë një Komision i përbashkët për të gjitha Ndërmarrjet Publike Komunale, mirëpo meqë ende nuk është miratuar ligji i ri edhe pse ka kaluar pothuajse të gjitha fazat dhe vetëm ka mbete që përfundimisht të shqyrtohet edhe njëherë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ne mund t'i emërojmë këto dy Komisione sepse nuk dihet edhe sa kohë mund të qëndroj ky ligj që është aktualisht.

Vlen të theksohet se paksa më të rëndësishme e kemi Komisionin e Aksionarëve për Stacionin e Autobusëve sepse janë në procedura të licencimit dhe çështjeve tjera me rëndësi, mirëpo nëse miratohet ligji i ri, atëherë sigurisht që do të veprojmë në bazë të tij sepse ndryshon komplet struktura, pastaj do të ketë ndryshim në bordet e Ndërmarrjeve ngase siç jemi në dijeni ka Ndërmarrje e cila më shumë ka anëtarë në bord sesa punëtorë, madje ka raste ku janë 5 drejtor të bordit kurse janë vetëm 2 punëtor, probleme të cilat kanë ngecë sepse ligji aktual është mjaft i koklavitur dhe nuk i zgjidh disa probleme, rast të ngjashëm kemi edhe ne Ndërmarrjen Publike Komunale për Banim ku janë vetëm 2 punëtor, ndërsa t'jua bëjmë ne 5 drejtor atyre nuk do të kishte gjenerim dhe nuk do të ishte e arsyeshme. Pavarësisht asaj që e ceka, ne presim që të ngrisim Komisionet në fjalë dhe ky komision t'i kryej punët deri sa të miratohet ligji i ri dhe pastaj të shikojmë se çfarë do të parasheh ai.

z.Avni Fetahu, në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahim dhe i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim, përkatësisht emërimin e nga dy anëtarëve në këto dy komisione.

z.Fitim Haziri, në emër të Grupit të LVV-së tha se e përkrahim ngritjen e këtyre dy komisioneve, ndërsa rreth propozimeve të anëtarëve të këtyre dy komisioneve ta shohim në mbledhjen e Kuvendit se si do të jetë marrëveshja, shpresojmë të mos jenë të gjithë nga radhët e LDK-së.

z.Rafet Llapashtica, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK-së e përkrahi këtë pikë që t'i rekomandohet Kuvendit për emërimin e anëtarëve në dy Komisionet në fjalë, theksoi, është obligim i Kuvendit që të emëroj anëtarët nga radhët e veta, natyrisht me shumicë të votave, andaj ne sot i rekomandojmë Kuvendit por për emra të shohim në mbledhje.

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, sa e kuptova, nga dy anëtarë i emëron Kuvendi në secilin Komision në fjalë kurse nga një anëtar emërohet nga Kryetari i Komunës.

z.Faik Muçiqi – DSHPMSh, theksoi, ligji e parasheh që Komisionet e Aksionarëve të Ndërmarrjeve Publike Komunale përbëhen prej tre anëtarëve ku dy prej tyre emërohen nga Kuvendi i Komunës, përkatësisht nga radhët e Kuvendit, ndërsa një anëtarë emërohet me vendim nga Kryetari i Komunës e që natyrisht ai vendim është pjesë përbërëse e vendimit të Kuvendit.

z.Fitim Haziri, theksoi, pa dashur të nënkuptohet që po insistoj të jem njëri prej atyre anëtarëve apo të jetë nga LVV-ja, do të doja që të paktën anëtarët të mos jenë vetëm nga LDK-ja, por të jenë edhe nga radhët e ndonjë subjekti tjetër politik. E them këtë me qëllim që të jemi sa më transparent, përndryshe shumicën në Kuvend e ka LDK-ja, mund të vendos ajo.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, përkatësisht emërimin e anëtarëve në Komisionet e Aksionarëve të dy Ndërmarrjeve përkatëse Komunale.

6. Zëvendësimi i një anëtari në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB (Komandanti i Stacionit të Policisë në Podujevë)

z.Fatmir Gashi, Kryesues, theksoi, kemi të bëjmë me zëvendësimin e një anëtari në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, fjala është për Komandantin e ri të Stacionit të Policisë në Podujevë i cili, sa jam në dijeni, para disa ditëve është emëruar. Është pozitivë e cila parashihet sipas detyrës zyrtare, konkretisht deri tani Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevës ka qenë Komandant z.Bekim Bislimi, ndërsa tani është z.Bekim Zogiani, dhe në këtë kontekst kërkohet që Kuvendi me vendim të bëjë zëvendësimin e tij në KKSB. Nëse ndokush dëshiroj fjalën urdhëroni, nëse jo e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit, zëvendësimi i një anëtari të KKSB-së, sipas asaj që e ceka.

Njëzëri i rekomandohet Kuvendit për zëvendësimin e anëtarit në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi, përkatësisht z.Bekim Zogiani Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë, zëvendëson z.Bekim Bislimin ish Komandant i Stacionit të Policisë në Podujevë

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-060/04-0037655/19
Podujevë,
07 maj 2019**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**